

Përmbledhje Jo-teknike e Raportit VNM

**Instalim për mbarështimin intensiv të pulave për
prodhim vezësh Koplik - Malësi e Madhe**

BEATA sh.p.k.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
1. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV I KRYERJES SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	3
1.1 Qëllimi dhe Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	3
1.2 Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin	4
1.3 Procedura e miratimit mjedisor të projekteve dhe veprimtarive.....	4
1.3 Çështjet me rëndësi mjedisore	5
2. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	5
2.1 Vendodhja e impiantit	5
2.2 Objektet dhe strukturat e projektit	5
2.3 Përshkrimi i procesit	6
1.4 Përshkrimi i linjës teknologjike	6
2.5 Infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit	8
2.6 Lidhjet e mundshme të aktivitetit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit.....	8
2.7 Lëndët e para të nevojshme për funksionim të instalimit	8
2.8 Aktivitete të tjera	8
3. PËRSHKRIMI I GJENDJES SË MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT.....	9
3.1 Përshkrimi i karakteristikave të Mjedisit fizik	9
3.1.1 Gjeologjia	9
3.1.2 Gjeomorfologjia	9
3.1.3 Tokat	9
3.1.4 Ujërat	10
3.1.5 Klima.....	10
3.2 Mjedisi biologjik	10
4.2.1 Flora	10
3.2.2 Fauna.....	11
3.2.3 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës.....	11
3.4 Mjedisi social dhe ekonomik	12

3.4.1	Popullsia	12
3.4.2	Zhvillimi ekonomik	12
4.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS	12
4.1	Metodika e kryerjes së Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis	13
4.2	Përcaktimi i receptorëve të ndjeshëm dhe zonave të ndjeshmërisë	13
4.3	Analiza e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të fazës operacionale të impiantit	14
4.4	Kohëzgjatja e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar	16
4.5	Shtirirja hapsinore e ndikimeve negative	17
4.6	Mundësia e kthyeshmërisë së pasojave të ndikimeve negative dhe kthimin e mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme	17
5.	PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT DHE MASAT E PROPOZUARA PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE	17
5.1	Përmbajtja e Planit të Menaxhimit të Mjedisit	18
5.1.1	Masat për zbutjen e ndikimeve në fazën e operimit	18
5.1.1	Menaxhimi i manureve	18
5.1.2	Menaxhimi i shpendëve të ngordhur	19
5.1.3	Masat për zbutjen e ndikimeve në ajër	19
5.1.4	Masat për kontrollin e ndotjes në ujëra	20
5.1.5	Masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në tokë	20
5.1.6	Masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në biodiversitet	20
5.1.7	Masat mbrojtëse ndaj rreziqeve nga patogjenët	20
5.1.8	Masa të tjera	21
5.2	Plani i Përfshirjes së Grupeve të Interesuara dhe Trajtimi i ankesave	21
5.3	Përmbajtja e Planit të Përballimit të Emergjencave	21
5.3.1	Zjarri	21
5.3.2	Epidemitë	22

HYRJE

Nëpërmjet projektit të propozuar shoqëria BEATA sh.p.k.synon zhvillimin e veprimtarisë së mbarështimit intensiv të pulave për prodhimin e vezëve. Për zhvillimin e kësaj veprimtarie kompania ka blerë një instalim të gatshëm dhe ka marrë lejet përkatëse për zhvillimin e aktivitetit. Instalimi, gjendet në verilindje të vendit, në territorin e Koplikut, Bashkia Malësi e Madhe, rreth 2.5 km në veriperëndim të qendrës së qytezës, 350-400 m në të majtë të rrugës nacionale Shkodër – Hani i Hotit.

Instalimi ekzistues kishte dy kapanone, një për pula me kapacitet 75,000 krerë dhe një për zogj me kapacitet 80,000 krerë. Me synimin për të dyfishuar kapacitetin e e prodhimit kompania ka shtuar edhe një kapanon tjetër për pula, me të njëjtin kapacitet prej 75,000 krerësh. Rritja e kapacitetit në 150,000 krerë gjithsej do të shoqërohet edhe një rikonstruksion/risistemim të përgjithshëm të tij.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, për zhvillimin e aktivitetit të propozuar kompania do të aplikojë për pajisen me Leje Mjedisore dhe me këtë synim ajo ka kryer procedurën e vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis të veprimtarisë dhe është në process të aplikimit për Deklaratën Mjedisore.

1. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV I KRYERJES SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

1.1 Qëllimi dhe Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Në zbatim të kërkesave të legjislacionit mjedisor shqiptar, për të garantuar një proces të drejtë të vendimmarrjes, çdo projekt i propozuar duhet të marrë paraprakisht edhe miratimin mjedisor, në themel të të cilit qëndron dokumenti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë.

Kryerja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të një aktiviteti të propozuar synon konsiderimin e çështjeve që lidhen me mjedisin pritës, fizik e social, që në fazat fillestare të tij. Në thelb të vlerësimit mjedisor të projektit qëndron evidentimi i pikëprerjeve të tij me legjislacionin në fuqi, vlerat natyrore që gjenden në zonën e projektit dhe si e sa do të ndikohen në rast të zbatimit të tij. Nëpërmjet identifikimit të ndikimeve të mundshme negative të zbatimit të projektit në vlerat natyrore të zonës pritëse, që në fazën e projektimit mund të merren masat e nevojshme për përmirësimet e duhura teknologjike, me qëllim zbutjen e ndikimeve dhe përshtatjen me kapacitetin bartës të mjedisit.

Raporti i VNM përmbledh një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit ekzistues pritës, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative dhe programin e monitorimit mjedisor.

1.2 Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Gjatë hartimit të raportit Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë së propozuar u konsultuan dokumente mbi politikat shtetërore të mbrojtjes së mjedisit, legjislacioni mjedisor dhe institucional shqiptar, i përgjithshëm dhe ai që lidhet në veçanti me projektin si dhe akte normativë dhe standartet industriale për veprimtarinë e propozuar.

- Ligji kuadër nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- Ligji nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
- Ligji nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Ligji nr.8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”.
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Ligji nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.
- Ligji nr.162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.
- Ligji nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Njëkohësisht, janë konsultuar aktet e mëposhtëm të cilët përcaktojnë standartet aktualë për mbrojtjen e biodiversitetit, shkarkimet në ajër, në ujëra dhe menaxhimin e mbetjeve:

- Vendim nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- VKM nr.229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”.
- VKM nr.371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.
- VKM nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- Vendim nr.435 datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr.676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”.
- VKM nr.686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimi të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”.
- VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
- Udhëzim nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

1.3 Procedura e miratimit mjedisor të projekteve dhe veprimtarive

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, projektet me ndikim në mjedis ndjekin procedurën e vlerësimi të ndikimit në mjedis dhe miratohen përpara fillimit të zbatimit të tyre në terren. Dokumenti kryesor në të cilin bazohet miratimi mjedisor i projektit është Raporti i VNM. Mbasi të jetë hartuar Draft Raporti, ai prezantohet për grupet e interesit në Dëgjuesën Publike përkatëse. Vërejtjet, sugjerimet dhe komentet e grupeve të interesuara përfshihen në raportin final, i cili bashkë me dokumentacionin tjetër të kërkuar,

paraqitet pranë Ministrisë së Mjedisit e cila e përcjell për shqyrtim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në varësi të projektit AKM mund të shprehet me Vendim/Deklaratë Mjedisore, e cila përfaqëson dokumentin orientues për autoritetet planifikues dhe i paraprin procedurës për paisjen me Leje Mjedisore të aktivitetit.

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, referuar kapacitetit të projektuar, aktiviteti përfshihet në Shtojcën 1, pika 17/a, dhe si i tillë i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis.

1.3 Çështjet me rëndësi mjedisore

Bazuar në natyrën e veprimtarisë, ndër çështjet kyç mjedisore që ka konsideruar raporti VNM veçohen:

- Statusi i zonës në të cilën do të zbatohet projekti;
- Menaxhimi i mbetjeve të aktivitetit, veçanërisht i mbetjeve organike (manure/plehu, pula të ngordhura);
- Distanca nga zonat e banuara për të vlerësuar ndikimin e mundshëm në komunitet (kryesisht aromat).

2. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1 Vendodhja e impiantit

Impianti ndodhet në verilindje të vendit, në territorin e Njësisë Koplík të Bashkisë së Malësisë së Madhe. Ai ndodhet i distancuar nga qendrat e banuara. Shtëpitë më të afërta janë pak më shumë se 1 km larg, në juglindje të tij dhe i përkasin lagjeve periferike të Koplíkut të Sipërm. Qyteza e Koplíkut gjendet rreth 2.5 km në juglindje të impiantit. Qendër tjetër e banuar më e afërt është Lashaj, 1.7 km në verilindje dhe fshati Jubicë, rreth 3 km në perëndim.

Terreni në të cilin është vendosur impianti zë një sipërfaqe rreth 18,000 m² dhe përfshihet në hartën topografike të shkallës 1:25,000 me nomenklaturë K-34-63-B-d (Koplíku). Terreni në të cilin është vendosur impianti përfaqëson një tokë pjesërisht të braktisura dhe pjesërisht bujqësore. Impianti është ekzistues dhe lloji i aktivitetit blegtoral përshtatet me pjesën tjetër të sipërfaqes.

2.2 Objektet dhe strukturat e projektit

Objektet kryesore të impiantit, që gjenden të instaluar, janë:

- dy kapanone të mbarështimit të pulave me kapacitet 75,000 krerë secili, me përmasa 100 x 15 m;
- një kapanon për rritjen e zogjve (inkubator) me kapacitet 80,000 krerë, me përmasa 80 x 15 m;
- reparti i përpunimit të ushqimit dhe siloset përkatës;
- reparti i paketimit të vezëve dhe magazina e produktit të gatshëm (pajisur me frigoriferë);
- zyrat e kompanisë.

Njëkohësisht impianti është i pajisur me objektet e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë siç është:

- kabina elektrike për furnizimin me energji elektrike nga rrjeti;
- pus për furnizimin me ujë të impiantit (së bashku me depozitën dhe pompën);
- gjenerator për rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike;
- kaldaja me gaz për inkubatorin.

2.3 Përshkrimi i procesit

Mbarështimi i pulave për vezë bëhet sipas një cikli periodik ripërtëritës të pulave nga mosha 17 deri në 75 javëshe. Procesi nis me blerjen e zogjve 1-2 ditësh, të cilët rriten në kapanonin inkubator për 17 javë (që përkon me momentin kur mund të fillojë prodhimi i vezëve), vijon me ciklin periodik të prodhimit të vezëve dhe përfundon me ambalazhimin e tyre në konfeksionin e përshtatshëm për t'u tregtuar.

Zogjtë kompania i siguron nga importi dhe merren për rritje 1-2 ditësh. Menjëherë vendosen në kapanonin përkatës i cili është i pajisur me kaldajë për të siguruar ngrohtësinë e nevojshme në fazat e para të rritjes. Gjatë periudhës së rritjes, zogjtë i nënshtrohen vaksinimit ndaj sëmundjeve të ndryshme, i cili kryhet sipas një skeme përkatëse të miratuar nga veterineri.

Zogjtë qëndrojnë në këtë kapanon për një periudhë prej 17 javësh, kohë në të cilën janë gati për t'i futur në ciklin e prodhimit të vezëve. Pas kësaj periudhe zogjtë transferohen në kapanonin e mbarështimit të pulave dhe futen në ciklin e prodhimit të vezëve, i cili zgjat rreth 1 vit e gjysëm, derisa pulat mbërrijnë moshën 70-75 javë. Bazuar në të dhënat e ciklit riprodhues periodik, çdo pulë prodhon rreth 320 vezë në vit (pothuajse një vezë në ditë).

Çdo pulë konsumon rreth 180-200 ml ujë/ditë dhe 105 gr ushqim. Ushqimi bazohet kryesisht në misër, i cili do të sigurohet nga importi (Serbia) dhe përziehet sipas raporteve të mëposhtme:

- 60% misër + 20% sojë + 11% lule dielli dhe vaj + 9% karbonat

Për kapacitetin e projektuar nevojiten rreth 16 – 18 ton ushqim në ditë dhe 15 ton ujë.

Cikli ripërtëritës i pulave shoqërohet edhe me ndërprerje të tij në një përqindje të caktuar, thënë ndryshe, rreth 0.4-0.5 e pulave që futen në proces ngordhin. Për 150,000 krerë që është kapaciteti i projektuar, përlllogariten të ngordhin 750 pula. Të tjerat, pas përfundimit të ciklit, shfrytëzohen për mish.

1.4 Përshkrimi i linjës teknologjike

Linja teknologjike e instaluar në impiant është prodhim i kompanisë italiane FACCO, e mirënjohur dhe me eksperiencë 60 vjeçare në këtë lloj industrie (www.facco.net).

Kapanonet - Në secilin prej kapanoneve janë të montuar bateritw me kafaze të vendosur mbi njëri-tjetrin në trajtë instalimesh gjatësorë, me hapsira të pjerrëta ndërmjet, mënyra më efikase për funksionimin e instalimit. Secili kapanon ka katër instalime të tilla, ku kafazët vendosen në të dy anët dhe në 4 kate. Secili kapanon është i pajisur me sisteme automatike të shpërndarjes së ujit, ushqimit,

ndriçimit, ventilimit (ajrimin), mbledhjes së vezëve, largimit të plehut dhe sistemin e ftohjes. Kapanoni i zogjve është i pajisur edhe me kaldajën që punon me gaz të lëngët.

Silose e ushqimit - Në siloset e ruajtjes së ushqimit garantohe mbajtja e ushqimit që përdoret për pulat dhe zogjtë në kushte konstante të temperaturës, lagështisë, rrezatimit e të tjerë faktorë atmosferikë që ndikojnë në cilësinë e tij. Kapaciteti i një silosi është 15 ton ushqim dhe është i instaluar mbi një mbajtëse të mbërthyer në bazament betoni. Prej këtij ushqimi shpërndahet nëpër kapanonet me ndihmën e një sistemi tubash. Ushqimi dërgohet nëpër kapanone në mënyrë automatike pas marrjes së sinjalit nga paneli i kontrollit, i cili sinjalizohet nga sensori i vendosur në linjat e shpërndarjes brenda kapanoneve.

Linja e shpërndarjes së ushqimit - Shpërndarja e ushqimit nëpër kafazë realizohet në mënyrë automatike. Kanalet e ushqimit janë të lidhur me karrelat lëvizëse, me ndihmën e të cilave realizohet shpërndarja e ushqimit në çdo kafaz. Shpërndarja e ushqimit bëhet sipas një programi të caktuar dhe miratuar dhe realizohet ndërmjet orës 8 të mëngjesit dhe 9 të darkës dhe në porcione të caktuara. Dozimi realizohet në mënyrë automatike nëpërmjet dozatorëve që mbushin kovat e linjës së shpërndarjes.

Linja e furnizimit me ujë - Edhe shpërndarja e ujit nëpër kafaze realizohet në mënyrë automatike. Çdo linjë ka depozitën e saj, e cila lëviz përgjatë kafazeve duke lëshuar me ndihmën e sistemit me pika sasinë e caktuar të ujit për secilin prej tyre. Furnizimi i depozitave bëhet nga linja kryesore e furnizimit me ujë të impiantit (pusi), ndërsa dozimi bëhet mbi bazën e ngarkesës që ka çdo kafaz (numrit të pulave).

Grumbullimi i vezëve - Grumbullimi i vezëve realizohet nëpërmjet transportierëve të brendshëm që përshkajnë të gjithë gjatësinë e kapanonit dhe janë të instaluar poshtë çdo sektori me kafazët e pulave. Transportieri është i lidhur me panelin e kontrollit, prej ku merr dhe komandën për lëvizje dhe i çon vezët e mbledhura në ashensorin e vendosur në fund të çdo instalimi. Prej këtu, nëpërmjet transportierit ajror (të jashtëm) vezët kalojnë në repartin e seleksionimit dhe amabalazhimit. Këtu, pasi kontrollohen dhe vulosen, vezët paktohen gati për në treg. Mbledhja e vezëve bëhet çdo ditë dhe ruajtja e tyre deri në momentin e largimit nga impianti (kur plotësohet sasia e kërkuar sipas kontratës me blerësin) realizohet në dhomë frigoriferike.

Vaskat e grumbullimit të manureve - Edhe jashtëqitjet e pulave dhe zogjve (manure) mbledhen në mënyrë automatike nëpërmjet transportierëve të instaluar poshtë çdo kati me kafazë. Me ndihmën e këtij sistemi, manuret transportohen në vaskat e mbledhjes së tyre, të vendosura në fund të çdo sektori. Që këtej, nëpërmjet një transportieri me hedhës me electromotor nxirren jashtë kapanonit në vendin e caktuar për to, në pritje të largimit nga impianti. Me kapacitetin aktual të impiantit, sasia e manureve është rreth 15 ton në ditë dhe merret nga fermerët e vegjël të zonës së Gruemirës që e përdorin për pleh.

Ndriçimi dhe ajrimi i kapanonëve - Ndriçimi dhe ajrimi i kapanonëve bëhen në mënyrë automatike. Sistemi përkatës realizon 16 orë dritë dhe 8 orë errësirë, të nevojshme për ciklin e zhvillimit normal të pulave dhe zogjve. Ndërsa sistemi i ventilimit garanton mbajtjen e ajrit në parametrat e kërkuar të temperaturës, lagështirës dhe përqindjes së azotit dhe dioksidit të karbonit. Nëpërmjet sensorëve përkatës, në varësi të ndryshimit të njërit prej këtyre parametrave, ventilatorët e montuar brenda kapanoneve, hyjnë automatikisht në funksionim.

Paneli i kontrollit (automatik) - I gjithë cikli kryhet në mënyrë automatike dhe komandohet e kontrollohet nëpërmjet panelit të kontrollit. Ky i fundit është i lidhur me sistemin kompjuterik, nëpërmjet sistemit të të cilit menaxhohet dhe kontrollohet i gjithë impianti. Secila prej linjave funksionon më vete, nëpërmjet baterisë përkatëse, duke bërë të mundur që çdo difekt apo nevojë për remont të mos pengojë funksionimin e të tjerave.

E gjithë veprimtaria e impiantit mund të kontrollohet nëpërmjet telekamerave dhe programeve kompjuterike përkatës nga menaxherët e kompanisë.

2.5 Infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit

Aktiviteti zhvillohet në një impiant ekzistues, ndërtuar për këtë qëllim. Si i tillë ai ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë duke nisur që nga rruga hyrëse (ose e aksesit), kabina elektrike, pusi nëntokësor për furnizim me ujë të pijshëm (bashkë me pompën dhe sistemin e shpërndarjes në impiant), sistemi i kapjes së ujërave të ndotur etj.

Ai gjendet shumë pranë rrjetit kombëtar të rrugëve, rreth 350 m në të majtë të rrugës nacionale Shkodër-Hani i Hotit, 2.5 km në veriperëndim të Koplikut.

2.6 Lidhjet e mundshme të aktivitetit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit

Veprimtaria zhvillohet në një impiant ekzistues, i cili ka funksionuar edhe më parë për të njëjtin qëllim (operuar nga kompani tjetër). Ai zhvillohet në një zonë të distancuar nga banesat dhe aktivitetet. Aktivitete të tjerë që zhvillohen në zonë janë kultivimi i sherbelës në disa ngastra dhe një nyje fraksionimi inertesh. Nga informacionet e marra s'ka plane për veprimtari ose projekte të rinj në të ardhmen.

2.7 Lëndët e para të nevojshme për funksionim të instalimit

Lëndët bazë të nevojshme për funksionimin e impiantit janë ushqimi për pulat dhe zogjtë, baza e të cilit është misri. Ushqimi sigurohet me një kontraktor të huaj, nga Serbia. Kjo zgjedhje kushtëzohet nga sasia e madhe e ushqimit që kërkohet për kapacitetin e projektuar (sasitë e nevojshme të ushqimit dhe struktura janë treguar në paragrafin 1.3 më lart) të impiantit, e pamundur të plotësohet nga prodhuesit vendas.

Nevojat për ujë plotësohen nëpërmjet pusit të hapur brenda impiantit, i cili është pjesë integrale e tij.

Furnizimi me energji elektrike sigurohet nga rrjeti publik, nëpërmjet kabinës private të ndërtuar për impiantin.

Në materialet e rëndësishme së parë për funksionimin e impiantit renditen edhe vaksinat dhe medikamentet e nevojshme, të cilat sigurohen brenda vendit ose në Itali.

2.8 Aktivitete të tjera

Aktivitete të tjerë të lidhur me veprimtarinë janë ato të transportit, të lëndës së parë (ushqimit) dhe produktit të gatshëm (vezëve). Të parat janë përgjegjësi e furnitorit, të dytat mund të kryhen edhe nga operatori i impiantit, në varësi të kontratës me blerësit.

Në aktivitetet e tjera përfshihet edhe largimi i manureve dhe mbetjeve të tjera, të cilat do të kryhen nga kontraktorët përkatës.

3. PËRSHKRIMI I GJENDJES SË MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT

3.1 Përshkrimi i karakteristikave të Mjedisit fizik

3.1.1 Gjeologjia

Në pikpamje gjeologjike, rajoni në të cilin gjendet zona e aktivitetit ndodhet në nënzonën e Malësisë së Madhe. Zona në studim gjendet në Fushën e Mbishkodrës, e cila e ka zanafillën në formimin e gropës tektoniko-karstike të Liqenit të Shkodrës gjatë pliocen-kuaternarit. Fusha është formuar si rezultat i rritjes graduale të koneve të fuqishme aluvionale në kurriz të liqenit. Pikërisht origjina e krijimit të fushës, përcakton edhe përbërjen litologjike të saj. Depozitimet më të përhapura janë aluvionet dhe proluvionet e kuaternarit të cilat vendosen me mospërputhje mbi një bazament që përfaqësohet kryesisht nga formacionet karbonatike të mesozoit dhe pjesërisht nga ato argjilore pliocenike. Këto depozitime përfaqësohen kryesisht nga zhavorre të rrumbullakosura mirë, në pjesën më të madhe të tyre të çimentuara dobët, me shtresëzim të qartë të zhavorreve të trasha dhe të holla. Trashësia në zonën e studimit luhetet ndërmjet 8 dhe 20 m, në drejtim të veriut.

Tektonika

Thyerjet kryesore shkëputëse normale që kanë çuar në krijimin e pellgut të Mbishkodrës, liqenit dhe fushës, janë ato tërthore me drejtim juglindje-veriperendim dhe verilindje-jugperendim.

3.1.2 Gjeomorfologjia

Bazuar në rajonizimin fiziko-gjeografik të Shqipërisë, zona ku është vendosur impianti shtrihet në pjesën veriore të Fushës së Koplikut që bën pjesë në Ultësirën e Mbishkodrës. Kjo pjesë e fushës ka një ngritje graduale nga perëndimi në lindje, ndërmjet kuotave 5 dhe 300 m mbi nivelin e detit. Ndërtimi litologjik, mosha e re dhe ndërprerja thuasje e plotë e furnizimit me aluvione nga Përroi i Thatë, janë faktorët kryesorë që kushtëzojnë çrregullsinë e relievit. Në karakterin e çrregullt kanë ndikuar edhe shtrirja e gjerë e kodrave të Moksetit në veriperendim dhe Postpojës në verilindje, me lartësi relative 200 m mbi nivelin e detit. Të gjitha këto veçori kanë ndikuar që fusha të jetë ndër më të thatat në vend. Kësaj i shtohet edhe zhvillimi i fuqishëm i karstit, i cili është përgjegjës për mungesën e plotë të rrjedhës sipërfaqësore dhe burimeve.

3.1.3 Tokat

Tipi më i përhapur i tokave në zone është ai i Tokave Livadhore të Kafenjta të Kuqërremta, të formuara përgjithësisht mbi depozitime deluviale, të përbëra nga produktet e alterimit të karbonateve. Në zonën e studimit ato janë formuar mbi shkëmbinj gëlqerorë dhe përbëhen nga argjila me përbërje konglomeratësh, copëra gurësh dhe brekçie gëlqerorësh. Përmbajtja në to e gurëve i bën të duken të fragmentuara. Këto toka janë fondi kryesor i tokave bujqësore në zonën në studim dhe janë të

përshtatshme për mbjelljen e duhanit, grurit dhe foragjereve. Aktualisht, ato pak që kultivohen, mbillen me sherbelë.

3.1.4 Ujërat

Zona në të cilën gjendet impianti përfaqëson një nga më të thatat në të gjithë vendin. Rrjeti ujqor sipërfaqësor përfaqësohet nga Përroi i Thatë, shtrati i thatë i të cilit gjendet rreth 1 km në veri të impiantit. Karakteristikë e përroit të Thatë, prej nga ka marrë edhe emrin, është mungesa e rrjedhës gjithëvjetrore në të dhe rrjedha vetëm disa orëshe në rast të rrebesheve të fortë. Bazuar në të dhënat ekzistuese, por edhe intervistat në terren me banorë të zonës, kjo dukuri ndodh një herë në 5-7 vjet dhe sasia e prurjeve është aq e madhe sa shkakton përmbytje në zonën e bregut të Liqenit. Zona më e prekur është fshati Kamicë, i cili gjendet 3.5 km vijë ajrore në veriperëndim të impiantit.

Rreth 5 km në perëndim të sheshit të impiantit gjendet Liqeni i Shkodrës.

Ujërat nëntokësore të Fushës së Mbishkodrës përfaqësohen nga burimet karstike që janë të përqëndruara kryesisht në pjesën perendimore, përgjatë bregut të Liqenit të Shkodrës, larg impiantit. Në zonën e impiantit, niveli i ujërave nëntokësore është ndërmjet 110-130 m.

3.1.5 Klima

Bazuar në rajonizimin klimatik të Shqipërisë, rajoni në studim, si pjesë e Ultësirës Perendimore, përfshihet në Zonën e Klimës Mesdhetare Fushore me regjim klimatik tipik mesdhetar.

Temperatura mesatare vjetore për Koplikun është 15°C, muaji më i ftohtë i vitit është janari me 4.6°C ndërsa ai më i nxehti është gushti me 25°C. Minimumi absolut i temperaturës është -13.6°C kurse maksimumi 40°C.

Sasia vjetore e reshjeve sipas matjeve në stacionin e Koplikut, i cili gjendet fare pranë zonës së projektit, është 1538 mm dhe rreth 67% e tyre bien në gjysmën e ftohtë të vitit. Muaji më i lagësht i vitit është nëntori me 238 mm. Reshjet e dëborës janë një dukuri jo e përvitshme në zonë.

3.2 Mjedisi biologjik

4.2.1 Flora

Terreni ku do të zhvillohet veprimtaria është djerrinë e përdorur më parë për qëllime bujqësore. Siç shihet edhe në foto, sipërfaqja e zonës përreth impiantit është pothuaj e zhveshur nga bimësia dhe në të janë instaluar lloje të paktë që i përshtaten këtyre terreneve. Megjithatë, në zonën përreth impiantit evidentohen katër lloje habitatesh:

Habitati i shkurretave të përziara i cili shtrihet në pjesën veriore të zonës në studim. Llojet më përfaqësuese janë shkurretat gjetherënëse si shega e egër (*Punica granatum*), driza (*Paliurus spinachristi*), manaferra (*Rubus ulmifolius*), fiku (*Ficus carica*). Si rezultat i fragmentimit llojet barishtore të shkurreve të përziara janë pak të përfaqësuara dhe vendin e tyre e kanë zënë bimë më dominante si mugashtëra (*Dittrichia viscosa*), telish (*Dactylis glomerata*), tërfili i arave (*Trifolium arvense*) etj. Habitati nuk konsiderohet me vlera të veçanta botanike për shkak të diversitetit të ulët të specieve. Njëkohësisht ai paraqitet i degraduar për shkak të mbishfrytëzimit dhe kullotjes pa kriter.

Habitati i pishave të egra, i cili ka një përhapje të kufizuar dhe të fragmentuar në verilindje të zonës në studim. Pishat janë mbjellë para shumë vitesh në brendësi të repartit ushtarak për uljen e temperaturave, por me kalimin e vitetve janë përhapur dhe më gjerë. Përgjithësisht pyjet halorë të dominuar nga pisha e egër (*Pinus halepensis*) përfaqësojnë pyje me diversitet të vogël specimesh. Shtresa e mëposhtme e habitatit është e mbuluar me shkurre si manaferra (*Rubus ulmifolius*), driza (*Paliurus spina – christi*), mreta gjethengushtë (*Phillyrea angustifolia*), shqopa (*Erica arborea*) etj.

Habitati i tokave bujqësore gjysëm natyrale të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të zonës. Në parë në të janë kultivuar kryesisht sherebela dhe bimë të tjera bujqësore. Për shkak të braktisjes pas 1990, sot këto terrene janë të mbuluar me lloje invazive si mugashtëra (*Dittrichia viscosa*), manaferra (*Rubus ulmifolius*) etj.

Habitati i tokave të mbjella me sherbelë që përfaqësohet nga një numër i kufizuar tokash bujqësore, të pastruara nga llojet invazive dhe të mbjellë me sherebelë.

3.2.2 Fauna

Habitati i tokave bujqësore gjysëm natyrale, i cili përfaqëson terrenin direkt pranë impiantit dhe zë sipërfaqen më të madhe në zonë mbështet një numër të madh shpendësh sidomos harabelorët (*Rendi Passeriformes*). Në dimër sipërfaqet e hapura përdoren për kullotje nga grupe të mëdha gardelinash të shoqëruara nga harabelorët e tjerë të vegjël. Gjatë verës fushat e hapura janë burim i mirë ushqimi dhe shumimi për shkurtën (*Coturnix coturnix*). Gushëkuqi europian (*Erithacus rubecula*), harabeli i shtëpisë (*Passer domesticus*), çerri (*Troglodytes troglodytes*), dervishët (*Alaudidae*) dhe shumë lloje të tjera si gardelinat ushqehen në pemëtoret dhe faroret e tjera të kultivuara në sipërfaqet bujqësore.

Gjitarët më të zakonshëm të zonës janë brejtësit, urithët dhe minjtë si miu i pishës (*Microtus thomasi*), miu i maqedonisë (*Mus macedonicus*), miu i zakonshëm i shtëpisë (*Mus domesticus*) dhe miu i zakonshëm i drurit (*Apodemus sylvaticus*). Ndër insektengrënësit më të zakonshëm janë hundëgjati dhëmbëbardhë i kopshteve (*Crocidura suaveolens*) dhe urithi i ballkanit (*Talpa stankovici*).

Zona ofron kushte për reptilët të tillë si hardhuca europiane jeshile (*Lacerta viridis*), hardhuca e murit (*Podarcis muralis*), breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*) etj.

3.2.3 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës

Zona e propozuar për zhvillimin e aktivitetit gjendet brenda zonës shqiptare të Liqenit të Shkodrës, shpallur “Rezervat Natyror i Menaxhuar” me VKM nr.684 datë 02.11.2005. Pjesa shqiptare e liqenit është shpallur Zonë e Mbrojtur e kategorisë së IV “Rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve”. Siç është treguar më lart, zona e projektit gjendet në një distance prej 350-400 m në të majtë të rrugës automobilistike Shkodër-Hani i Hotit (drejtimi Hani i Hotit), e cila përfaqëson kufirin lindor të zonës së mbrojtur. Referuar hartës së zonimit të kësaj ZM, bashkëlidhur VKM (Figura 4.6), zona e projektit përfshihet në zonën e zhvillimit tradicional e cila tregohet në hartë me ngjyrë të verdhë dhe numrin 3 (Pika 4/c e VKM), në të cilën zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

3.4 Mjedisi social dhe ekonomik

Bazuar në ndarjen e re administrative, impianti gjendet brenda territorit të Njesisë Administrative Koplik të Bashkisë së Malësisë së Madhe. Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Kopliku, Gruemira, Kastrati, Kelmendi, Qendra dhe Shkreli dhe ka nën administrimin e saj dy qytete (Koplik dhe Bajzë) dhe 56 fshatra. Malësia e Madhe kufizohet në veri me Malin e Zi dhe në jug me Bashkinë Shkodër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Koplikut.

Impianti gjendet i distancuar nga qendrat e banuara. Shtëpitë më të afërta janë pak më shumë se 1 km larg, në juglindje të tij dhe i përkasin lagjeve periferike të Koplikut të Sipërm. Qyteza e Koplikut gjendet rreth 2.5 km në juglindje të impiantit. Qendër tjetër e banuar më e afërt është Lashaj, 1.7 km në verilindje dhe fshati Jubicë, rreth 3 km në perëndim.

3.4.1 Popullsia

Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia e Malësisë së Madhe është 30,823 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki ka 53,918 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 951.01 km² me një densitet prej 56.69 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 32.41 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Periodha e tranzicionit, si kudo në Shqipëri është shoqëruar edhe këtu me lëvizje të mëdha të popullatës. Emigracioni vazhdon akoma edhe sot, sidomos tek popullsia e re në moshë. Papunësia është në nivele të larta dhe të ardhurat kryesore sigurohen nga emigracioni (remitancat).

3.4.2 Zhvillimi ekonomik

Ndonëse bashkia është e pasur në bukuri natyrore që janë një bazë shumë e mirë për zhvillimin e turizmit, zhvillimi ekonomik mbështet tek bujqësia dhe blegtoaria.

Aktualisht ekonomia është e drejtuar nga bujqësia, blegtoaria, kultivimi i bimëve medicinale dhe peshkimi në masë të vogël. Duhet theksuar se edhe zhvillimi i bujqësisë ka mjaft probleme për shkak të tokave me cilësi jo shumë të mira, të cilat zenë një pjesë të konsiderueshme të pjesës fushore. Më së shumti në zonë kultivohet frutikultura, duhani dhe bimët industriale e eterovajore. Për nxitjen e prodhimit është i nevojshëm subvencionimi i fermerëve dhe ngritja e një qendre për grumbullimin e duhanit dhe bimëve medicinale.

Probleme të tjera për zonën mbeten: furnizimi me ujë të pijshëm, pastrimi i mbetjeve të depozituara në shtratin e Përroit të Thatë; përmirësimi i rrugëve lokale, kategoria 3, të cilat lidhin fshatrat e zonës.

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS

Nëpërmjet analizës së ndikimeve parashikohet madhësia dhe shkalla e ndikimit që një aktivitet i propozuar do të ketë në një receptor të mjedisit, në kohë dhe hapsirë, dhe mundësia e zbutjes së tij.

Në një gjykim të përgjithshëm, ndikimet kryesore që një impiant i rritjes intensive të pulave për vezë ka në mjedis përmbledhet në: shkarkimet e amoniakutsi rezultat i prodhimit të manureve (plehu); gjenerimi

i mbetjeve organike si shpendët e ngordhur; çlirimi i aromave dhe zhurmave nga kapanonet e shpendëve; rreziku nga patogjenët. Përrjashtuar aromat dhe zhurmat, ndikimet e tjera, nëse nuk kontrollohen përmes planit të menaxhimit të mjedisit dhe masave zbutëse përkatëse mund të shkaktojnë ndotje të konsiderueshme të ajrit, tokës dhe ujërave.

Për një vlerësim sa më real të ndikimeve të mundshme në mjedis është konsultuar literaturë bashkëkohore dhe materiale që lidhen me projekte të ngjashëm.

4.1 Metodika e kryerjes së Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis

Në mënyrë më të detajuar, identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis të veprimtarisë ka ndjekur këto etapa:

- Identifikimi i të gjitha operacioneve që kanë ndërveprim me mjedisin në tërësi ose receptorë të veçantë të tij;
- Identifikimi i shkarkimeve të pritshme dhe efekteve të mundshme të tyre (ndikimeve) në burime dhe receptorë mjedisorë (burime konsiderohen ajri, uji, toka, ndërsa receptorët përfshijnë lloje të caktuar bimësh dhe kulturash bujqësore, specie të faunës, komunitete pranë zonës);
- Përcaktimi i llojit të ndikimit në burimet dhe receptorët mjedisorë (direkte ose indirekte);
- Përcaktimi i natyrës dhe shkallës së ndikimit (p.sh. ndikimi i shkarkimeve të amoniakut është i ndryshëm për toka bujqësore dhe terrene natyrore: në rastin e parë konsiderohet ose jo ndikim në varësi të kulturave që kultivohen, ndërkohë që për vegjetacionin natyror mund të shkaktojë dëmtim serioz).

Analiza e ndikimeve të veprimtarisë së propozuar është kryer duke identifikuar dhe vlerësuar secilin prej tyre bazuar në një grup kriteresh dhe shkallë kategorizimi.

4.2 Përcaktimi i receptorëve të ndjeshëm dhe zonave të ndjeshmërisë

Vlerësimi i shkallës së ndikimeve të veprimtarisë në mjedis varet në mënyrë të konsiderueshme edhe nga prania në zonën përreth impiantit të receptorëve të ndjeshëm mjedisorë të cilët mund të jenë me natyrë fizike, biologjike, sociale apo kulturore dhe/ose arkeologjike. Për këtë arsye, gjatë procesit të vlerësimit të ndikimeve është e rëndësishme të evidentohen zonat dhe receptorët e ndjeshëm mjedisorë në afërsi të instalimit. Referuar literaturës bashkëkohore, efektet në mjedis të shkarkimeve nga pulari të mëdha, shfaqen deri në një distancë të konsiderueshme prej vendit të instalimit. Për këtë arsye është e rekomandueshme që kur flitet për zona dhe receptorë të ndjeshëm mjedisorë, të merret në shqyrtim një zonë me rreze më të gjerë, rreth 2 km¹ nga impianti.

Referuar vrojttimeve në terren dhe burimeve dytësore të informacionit, siç janë reflektuar në kapitullin mbi përshkrimin e mjedisit në zonë, në një zonë rrethuese me rreze 2 km nga impianti nuk evidentohet asnjë receptor mjedisor me rëndësi të veçantë dhe me ndjeshmëri të lartë. Impianti përfshihet brenda kufijve të ZM “Rezervat natyror i menaxhuar” i pjesës shqiptare të Liqenit të Shkodrës, por, referuar

¹ Assessing environmental impacts of poultry farms. Supplementary guidance, M J Sharp Environmental Consultant August 2003

hartës përkatëse dhe zonimit ai gjendet më shumë se 5 km larg nga bregu i liqenit dhe brenda zonës së përdorimit tradicional.

4.3 Analiza e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të fazës operative të impiantit

Teknologjia që përdor instalimi është bashkëkohore dhe me cikël të mbyllur. Siç edhe është treguar në paragrafin mbi projektin teknik, i gjithë procesi zhvillohet në mënyrë të automatizuar brenda kaponëve të mbyllur dhe kontrollohet nëpërmjet sensorëve të vendosur në seksionet përkatës.

Ndikimet negative kryesore të mundshme në mjedis të veprimtarisë përfshijnë:

Gjenerimi i plehut dhe Ndikimet nga shkarkimet e amoniakut (NH₃) – Amoniacu nuk prodhohet drejtpërsëdrejti nga sekretimi i pulave (jashtëqitja). Ai është një bashkëprodukt i zakonshëm në mbetjet e pulave. Manuret e tyre, të cilët janë feçet e përziera me urinë, përmbajnë azot në trajtën e acidit urik. Përlllogaritjet që në plehun e pulave industriale ka 4-6% N total. Ky azot është sasia e paasimiluar e azotit të dhënë nëpërmjet ushqimit. Prezenca e acidit urik në manure është një burim i përhershëm i amoniakut i cili formohet nga shpërbërja e të parit nën veprimin e agjentëve mikrobialë.

Në impiantin e BEATA-s prodhohet rreth 15 ton në ditë pleh nga pulat dhe zogjtë. Aktualisht, plehu (manuret) i prodhuar nuk magazinohet në impiant; ai largohet 2-3 herë në ditë (transportieri e hedh direkt në karrocerinë e makinës) dhe u jepet fermerëve të zonës së Gruemirës, rreth 12 km vijë ajrore distancë në juglindje të impiantit, të cilët e përdorin si pleh për toka në të cilat kultivohet duhan.

Analizuar në kontekstin e mjedisit ku gjendet impianti dhe mënyrën aktuale të menaxhimit të manureve, ndikimet negative të amoniakut mund të vlerësohen për dy mjedise të ndryshme: brenda impiantit dhe zonës përreth dhe, në tokat ku ai përdoret.

Brenda impiantit dhe zonën përreth shkarkimet e azotit kanë si burim manureve e shpërndara aksidentalisht gjatë ngarkimit ose emetimeve të tij nga brenda kaponëve dhe vlerësohen të një shkalle të ulët sepse:

- Zona gjendet larg trupave ujorë sipërfaqësorë kështuqë bie rreziku i ndotjes së tyre nëpërmjet rritjes së mundshme të përqendrimit të N në ta.
- Pjesa më e madhe e tokave përreth impiantit janë toka të braktitura dhe fare pak bujqësore, të varfëra në habitate natyrale. Emetimet e amoniakut mund të shkaktojnë acidifikim të tokës në rast se ato paraqesin aftësi të ulët të neutralizimit të acideve.
- Shkarkimet e amoniakut si rezultat i veprimtarisë mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit në zonë pasi janë përgjegjëse për formimin e lëndës së grimcuar PM_{2.5} dhe aromave. Gjithsesi të dy këta ndikime do të kenë efekt të limituar gjykuar nga burimi dhe fakti që komunitetet më të afërta gjenden rreth 1 km distancë nga impianti.

Sa lidhet me tokat bujqësore në Gruemirë për të cilat përdoret plehu, në to kultivohet duhan. Sasia e plehut që përdoin bujqit dhe fermerët e vegjël të zonës është rreth 5.5 ton/dylym. Transporti për në zonë bëhet me automjet të mbuluar dhe shkarkohet direkt në arën përkatëse. Për këtë ndiqet një plan shpërndarje sipas nevojave.

Gjenerimi i mbetjeve – Në mbetjet e prodhuara, veç manureve të trajtuara në lart, një vend të rëndësishëm zenë **shpendët (pulat dhe zogjtë) e ngordhur**, menaxhimi i të cilave përbën një ndër çështjet kryesore mjedisore në impiantet e mbarështimit të pulave industriale.

Referuar projektit teknik, lloji i pulave që do të mbarështohet në impiant ka një normë vdekshmërie në masën 0.4-0.5 %, që do të thotë rreth 400-500 pula në vit për 100 mijë krerë. Impianti mbarështon 150 mijë pula dhe 80 mijë zogj që do të thotë brenda një viti mund të ketë deri në 800 shpendë të ngordhur, të cilët kërkojnë menaxhimin e duhur, në të kundërt kthehen në një burim të rëndësishëm ndotje jo vetëm për shkak të lëndëve organike, por edhe për patogenët që mund të gjenerojnë duke u dekompozuar. Për një peshë mesatare të pulave prej 1.8 kg, sasia totale e shpendëve të ngordhur në një vit është rreth 1.5 ton.

Ndikimet në ajër – Cilësia e ajrit në zonë mund të ndikohet nga:

- Emetimi i aromave të cilat mund të vijnë direkt nga brenda kapanoneve nëpërmjet sistemit të ventilimit; nga shpërndarja aksidentale e manureve; dhe, gropa e depozitimit të shpendëve të ngordhur. Fluksi i aromave do të jetë më i ndjeshëm gjatë pastrimit të kapanoneve ose në raste të keqmenaxhimit të manureve dhe mbetjeve të tjera.
- Gjenerimi i gazeve CO, NOx dhe SOx nga kamionët që transportojnë lëndën e parë që përdoret si ushqim dhe prodhimin e gatshëm (vezët), nga kaldaja që ngroh inkubatorin e zogjve dhe gjeneratori. Sasia e gazeve të emetuar parashikohet të jetë minimale pasi nuk pritet të qarkullojnë më shumë se 5 kamionë në ditë. Nga ana tjetër, kaldaja e cila ka fuqi të vogël e për rrjedhojë edhe emetime të pakta, funksionon maksimalisht 3 muaj në vit. Ndërsa gjeneratori funksionon vetëm në raste të ndërprerjes së energjisë elektrike nga rrjeti.
- Emetim pluhuri gjatë shkarkimit të ushqimit dhe operacioneve të menaxhimit të mbetjeve, veçanërisht në kohë të thatë ose me erë.
- Gjenerim zhurmash nga sistemi i ventilimit dhe transporti.

Të gjitha shkarkimet në ajër si më lart pritet të kenë një ndikim të ulët deri në të papërfillshëm në cilësinë e tij sepse impianti është i distancuar nga qendrat e banuara dhe efektet do të mbeten vetëm brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria.

Ndikimet në ujëra – Vetë veprimtaria nuk përfshin operacione që gjenerojnë ujëra të ndotur. Urina e shpendëve, përveçse është minimale pasi uji i pijshëm u jepet pulave i dozuar saktësisht sipas nevojës që ata kanë, del i bashkuar me manuret, jo si mbetje e lëngët. Në këto kushte gjenerimi i ujërave të ndotur limitohet në ujërat e pastrimit të kapanoneve dhe shpëlarja e mundshme e mbetjeve (përfshirë manuret) nga shirat në kushte të keqmenaxhimit të tyre. Në impiant do të ndërtohet një sistem kanalesh sipërfaqësorë për mbledhjen e ujërave të shpëlarjes, të cilët do të përfundojnë në vaskën e dekantimit. Këtu do t'i nënshtrohen një trajtimi fiziko-mekanik dhe më pas, ujërat mund të shkarkohen në mjedis.

Ujëra të tjerë të ndotur janë ujërat urbanë nga veprimtaria e personelit mbledhja e të cilëve bëhet me gropë septike. Impianti është mjaft larg qendrave të banuara, të cilat nga ana e tyre gjithashtu nuk kanë sistem kanalizimesh.

Ndikimet në biodiversitet – Ndikimet në biodiversitet të veprimtarisë në fazën e saj operacionale limitohen në rrezikun e transmetimit të sëmundjeve infektive të pulave tek popullatat e shpendëve në zonë. Sëmundjet kryesore të pulave i dedikohen *Campylobakterit* dhe *Salmonelas*, të gjendura të dyja në manure. Gjithashtu viruse të tillë si H5N1, i njohur si “gripi i shpendëve” mund të transmetohet nga pulat tek një popullatë më e gjerë shpendësh. Rreziku është i njëjtë edhe për shpendët migratorë që mund të vizitojnë zonën dhe në këtë rast ndikimi do të kishte shtrirje përtej kufijve të vendit. Megjithatë ky ndikim mund të kontrollohet dhe minimizohet në maksimum nëpërmjet zbatimit të praktikave të duhura të menaxhimit të manureve dhe Planit të Menaxhimit të Mjedisit në tërësi.

Në lidhje me bimësinë, nuk parashikohet që faza operacionale të ndikojë në të edhe për faktin se zona përreth impiantit është e varfër në bimësi natyrale dhe bimë të kultivuara.

Ndikimet në tokë – Mundësitë e ndotjes së tokës në fazën operacionale janë të pakta dhe mund të shkaktohen nga praktika të keqmenaxhimit të mbetjeve (shpërndarje e pakontrolluar dhe për një kohë të gjatë e plehut) i cili përmban elementë ushqyes si azot, fosfor dhe antibiotikë, të cilët në kushte të përqëndrimit të lartë kthehen në ndotës. Tjetër mundësi ndotje janë rrjedhjet aksidentale të karburanteve apo likuideve të tjerë që gjenden brenda impiantit (përfshirë kimikate pastrimi etj.).

Rreziku nga patogjenët

Një element me shumë rëndësi që duhet konsideruar kur trajtohen ndikimet e mundshme të një pularie në komunitetet në afërsi të saj është edhe rreziku nga patogjenët. Sëmundjet kryesore të pulave i dedikohen *Campylobakterit* dhe *Salmonelas*, të gjendura të dyja në manure. Të dy këta patogjenë shkaktojnë diare, shtërngime, ethe, të përziara dhe të vjella. Gjithashtu edhe virusi H5N1, i njohur si “gripi i shpendëve” mund të transmetohet nga pulat tek njerëzit, siç ndodhi në vitin 2008 në një numër të konsiderueshëm shtetesh aziatike. Aparati respirator mundet gjithashtu të përbëjë një burim të transmetimit të sëmundjeve dhe infeksionit të mushkërive. Rekomandohet që personat që janë në kontakt direkt me shpendët, brenda kapanoneve, të jenë të pajisur me maska mbrojtëse për frymëmarrjen. Nga ana tjetër, ky personel duhet të jetë i testuar nga ana mjeksore për t’u siguruar që nuk është mbartës i këtyre patogjenëve, të cilët mund të transmetohen tek pulat.

Shtim i trafikut në zonë – Siç është treguar edhe më lart, në paragrafë të ndryshëm të raportit, numri maksimal i kamionëve që mund të qarkullojnë për në - dhe nga impianti nuk është më i lartë se 5 automjete në ditë. Në kushte të një zone rurale me trafik të moderuar (kryesisht për shkak të afërsisë me pikën kufitare të Hanit të Hotit), ky numër kamionësh nuk parashikohet që të shkaktojë probleme në qarkullim. Impianti ka rrugë aksesit të tijën e cila lidhet me rrugën nacionale Shkodër-Hani i Hotit.

4.4 Kohëzgjatja e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Të gjitha ndikimet e mundshme të veprimtarisë, identifikuar si më lart, mund të karakterizohen si ndikime me karakter të përkohshëm, pasi të gjitha lidhen me kohëzgjatjen e aktivitetit. Me ndërprerjen e aktivitetit, pushojnë së vepruari edhe ndikimet që rrjedhin prej tij. Duke qenë se veprimtaria nuk përfshin operacione që çojnë në shndërrimin e cilësive të mjedisit si tokës, ujërave dhe ajrit, asnjë prej ndikimeve nuk konsiderohet mbetës.

4.5 Shtrirja hapsinore e ndikimeve negative

Shtrirja hapsinore e ndikimeve të mundshme në mjedis nga veprimtaria është e një shkalle të ulët. Mbarështimi i pulave për vezë konsiston në operacione që zhvillohen në mjedise të mbyllur (kapanone) brenda impiantit. Njëkohësisht, zbatimi rigoroz i masave zbutëse të ndikimeve në mjedis që përmban Plani i Menaxhimit të Mjedisit, garanton kontrollin e shkarkimeve të veprimtarisë në mënyrë që ato të mbeten brenda kufijve të lejuar. Në këto kushte, shtrirja hapsinore e ndikimeve është e kufizuar brenda impiantit dhe një zonë të vogël rrethuese. Nga ana tjetër, impianti ndodhet shumë i distancuar nga qendrat e banuara dhe aktivitetet e tjera dhe në afërsi të tij nuk janë evidentuar zona ose receptorë të ndjeshëm mjedisorë. Për rrjedhojë, të vetmet operacione që shtrijnë ndikimin e tyre në një zonë më të gjerë, janë ato të transportit, që gjithsesi janë minimale pasi bëhet fjalë për transport misri dhe vezësh dhe një volum të vogël automjeteve, maksimalisht 5 kamionë në ditë.

4.6 Mundësia e kthyeshmërisë së pasojave të ndikimeve negative dhe kthimin e mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme

Asnjë nga ndikimet e mundshme negative të projektit nuk ka karakter mbetës, që do të thotë se me zbatimin e një plani rehabilitimi, sipërfaqja e përdorur për impiantin mund të kthehet në gjendjen e mëparshme.

5. PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT DHE MASAT E PROPOZUARA PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE

Zbutja dhe minimizimi i ndikimeve negative të identifikuar në mjedis është plotësisht i mundshëm në sajë të zbatimit me rigorozitet të Planit të Menaxhimit të Mjedisit që do të përgatisë kompania. Në sajë të zbatimit të suksesshëm të Planit të Menaxhimit të Mjedisit sigurohet:

- Zhvillimi i veprimtarisë duke marrë në konsideratë aspektet mjedisore me qëllim mbrojtjen e vlerave natyrore nga dëmtimi dhe shkatërrimi si dhe shëndetit nga rreziqet biologjike.
- Eliminimi ose minimizimi i ndikimeve negative në mjedisin fizik, biologjik dhe social.
- Pajtueshmëria e plotë me legjislacionin shqiptar, standartet dhe kushtet e lejeve përkatëse.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit (PMM) është një instrument që synon të ndihmojë operatorin e impiantit për mbrojtjen e mjedisit gjatë zhvillimit të veprimtarisë. Si i tillë, kërkesat e tij janë të detyrueshme të zbatohen nga kompania operatore si dhe palët e treta ndërvepruese, kontraktorët dhe nënkontraktorët.

Dokumenti i PMM përmban një përshkrim të përgjithshëm dhe më tej detajohet me masa zbutëse përkatëse për ndikimet e identifikuar. Në vështrim të përgjithshëm masat zbutëse të ndikimeve në mjedis klasifikohen në:

- masa teknike,
- masa organizative.

Masat teknike synojnë përshtatjen e projektit me vlerat natyrore të zonës me qëllim mbrojtjen në maksimum të tyre.

Masat organizative përfaqësojnë të gjitha veprimet që duhet të ndërmarrin ushtruesit e veprimtarisë (përfshirë kontraktorin e ndërtimit) për mbrojtjen e vlera natyrore të zonës dhe rritjen e performancës mjedisore të aktivitetit.

5.1 Përmbajtja e Planit të Menaxhimit të Mjedisit

Plani i Menaxhimit të Mjedisit detajohet me masa specifike sipas natyrës së operacioneve të veprimtarisë dhe shkarkimeve përkatëse në mjedis, të cilat hartohen dhe zbatohen për të gjitha fazat e zhvillimit të veprimtarisë. Plani i menaxhimit të Mjedisit duhet të përmbajë:

1. Masat zbutëse të ndikimeve në mjedis për fazën operacionale, përfshirë:
 - masat për menaxhimin e mbetjeve organike (manuret, zogjtë e ngordhur) bazuar në praktikat më të mira për parandalimin e ndotjes dhe reduktimin e rreziqeve,
 - masat zbutëse të ndikimeve në cilësinë e ajrit si aromat, pluhuri dhe zhurma,
 - masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në ujëra,
 - masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në tokë,
 - masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në biodiversitet,
 - masat mbrojtëse ndaj rreziqeve nga patogjenët.
2. Planin e përballimit të emergjencave si epidemitë, me veprimet konkrete, personat përgjegjës, kontaktet, afatet kohore të veprimit etj.
3. Planin e përfshirjes së grupeve të interesuara dhe mekanizmin e trajtimit të ankesave.
4. Matrica kuadër e masave zbutëse, me afatet kohore dhe personat përgjegjës.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit është objekt i ndryshimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme në varësi të performancës mjedisore të aktivitetit, problemeve mjedisore dhe efektivitetit të masave korrektuese.

5.1.1 Masat për zbutjen e ndikimeve në fazën e operimit

5.1.1 *Menaxhimi i manureve*

- Aktualisht manuret nuk magazinohen në impiant. Ato shkarkojnë drejtpërsëdrejti në karrocerinë e automjetit transportues dhe dërgohen tek fermerët e vegjël të zonës së Gruemirës, të cilët e përdorin si pleh natyral për ngastrat e mbjella me duhan. Për të shmangur ndotjet e mundshme gjatë transportit pranë qendrave të banuara ku kalon, ai realizohet me automjet të mbuluar për të shmangur mundësinë e çlirimit të aromave dhe pluhurit. Rekomandohet që kompania të marrë masa për trajtimin termik të plehut përpara se ta shpërndajë atë tek fermerët. Kjo shmang rrezikun e patogjenëve që mund të gjenden në manure.
- Në impiant do të mbahen të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e manureve të larguar çdo ditë, fermerët të cilëve u jepet plehu, sasinë përkatëse, madhësia e ngastrave, lloji i kulturës që kultivohet.
- Në planet afatgjata kompania ka planifikuar të ndërtojë një qelizë për kompostimin e plehut. Ndërkohë, duke marrë në konsideratë një situatë në të cilën jo e gjithë sasia e prodhuar mund

të shitet tek fermerët, do të ndërtohet një magazinë për depozitimin e përkohshëm të manureve.

5.1.2 Menaxhimi i shpendëve të ngordhur

Shpendët e ngordhur duhen larguar nga kapanonët periodikisht. Në praktikat më të zakonshme të menaxhimit të tyre renditen: groposja, djegia në një incinerator të posaçëm, kompostimi në mënyrë të kontrolluar. Në mungesë të incineratorëve për djegien e tyre, kompania do të zbatojë këto masa:

- Në planin afatshkurtër do të ndërtojë një qelizë (gropë) të posaçme për groposjen e tyre, e cila do të përmbushë kushtet e izolimit. Për çdo rast të groposjes, karkasat do të mbulohen me dhe e më pas do të hidhet gëlqere për dezinfektim. Zgjidhje tjetër është mundësia e depozitimit të tyre në landfillin e Bushatit, kundrejt marrëveshjes së posaçme me kushtet specifike. Në rast duhet të garantohet që karkasat nuk janë mbajtëse të patogjenëve të rrezikshëm dhe të jenë të pranueshme nga landfilli. Kompania do të vendosë frigoriferë të posaçëm për ruajtjen e shpendëve të ngordhur deri në momentin e transportit i cili do të kryhet me mjete të posaçme dhe kundrejt protokollit të kërkuar.
- Në planin afatgjatë do të kompostohen sipas teknologjisë përkatëse. Plehu i karkasave vlerësohet më i mirë se vetë plehu i pulave dhe ka interes ekonomik.

5.1.3 Masat për zbutjen e ndikimeve në ajër

Masat për kontrollin e pluhurit

- Spërkatja brenda kapanoneve – shmang daljen e pluhurit jashtë nëpërmjet ventilatorëve.
- Kontrolli i shpërndarjes aksidentale të plehut për të shmangur tharjen e tepërt të tij.
- Planifikimi dhe optimizimi i operacioneve të transportit, shkarkimit të ushqimit dhe ngarkimit të plehut.
- Gjelbërimi me shkurre dhe bar i mjediseve të brendshme.
- Kontrolli i shpejtësisë së automjeteve në rrugë dhe rrugica jo të asfaltuara brenda impiantit dhe jashtë tij.

Masat për kontrollin e aromave

- Mbajtja e sasisë së lejueshme të manureve brenda kapanoneve. Shmangia e grumbullimit të manureve në sasi të mëdha dhe për një kohë të gjatë.
- Spërkatja e brendshme e kapanoneve për kontrollin e temperaturës brenda kapanoneve – temperaturat në kufijtë minimalë ndihmojnë në uljen e sasisë së aromave që dalin përmes kapanoneve.
- Monitorimi dhe kontrolli i formulës së ushqimit dhe miksuesve – studimet kanë treguar se formula e ushqimit dhe lloji i miksuesve kanë ndikim në aromën e plehut.
- Në rast të problemeve të zgjatur, do të aplikohet vendosja e filtrave të veçantë në ventilator.

5.1.4 Masat për kontrollin e ndotjes në ujëra

Ndotja e ujërave mund të shkaktohet nga shpërndarja aksidentale e manureve (masat për menaxhimin e të cilave janë treguar më lart) ose nga ujërat shpëlarës të shirave dhe ata që dalin nga pastrimi i kapanoneve. Për të shmangur ndotjet e mundshme:

- Do të përfundojë së ndërtuari sistemi i mbledhjes së ujërave të shiut, me kanalet, puset dhe vaskën e dekantimit.
- Llumrat, të cilat duhet të hiqen jo më larg se një herë në tre muaj, do të thahen dhe do të përziejehen me manure.
- Me këtë sistem do të lidhen edhe kanalet ku derdhen ujërat e pastrimit të kapanoneve.

5.1.5 Masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në tokë

Mënyra e operimit të impiantit dhe mjedisi ku ai është i vendosur, përjashtojnë ndikimet e mundshme në tokë brenda impiantit. Ndikimet në tokë janë të mundshme në arat ku përdoret plehu. Për të shmangur ndotjen e mundshme të tokës nga përdorimi i plehut të pulave:

- Do të kërkohen analizat e tokës që do të plerohet.
- Do të vlerësohet përshtatshmëria e bimëve që kultivohen me plehërimin me plehun natyral të pulave.
- Mbi bazën e analizave të tokës dhe plehut, do të përllogaritet sasia e nevojshme për plehërim në mënyrë që të shmangët shpëlarja dhe depozitimi i tepërt i nutrientëve në tokë.

5.1.6 Masat mbrojtëse ndaj ndikimeve në biodiversitet

Në ndikimet në biodiversitet renditen aksidentet e mundshme ngaj specieve të faunës, kryesisht reptilët, dhe mundësia e transmetimit të patogjeneve, të cilët do të trajtohen më poshtë.

Për të shmangur aksidentet e mundshme ndaj llojeve të veçanta të faunës, do të zbatohen këto masa:

- Rrethimi i impiantit për të penguar hyrjen e tyre brenda tij.
- Automjetet që do të hyjnë dhe dalin në impiant do të këshillohet të ecin me shpejtësi të kufizuar në rrugën hyrëse për në impiant.

5.1.7 Masat mbrojtëse ndaj rreziqeve nga patogjenët

Rreziku nga patogjenët, veç dëmeve në mjedis, shkakton para së gjithash dëm ekonomik për vetë kompaninë. Në këto kushte, mbrojtja ndaj tyre merr një rëndësi të veçantë. Konkretisht:

- Do të kryhet sipas një programi rigoroz vaksinimi i shpendëve.
- Do të kryhen kontrollet periodikë për shëndetin e shpendëve.
- Do të kryhen kontrollet periodikë të stafit operator për të shmangur përhapjen e mikrobeve dhe viruseve të mundshëm nga njerëzit tek shpendët.
- Do të pastrohen rregullisht kapanonët për të shmangur zhvillimin e agjentëve mikrobialë brenda tyre, me pasoja infektive në shëndetin e shpendëve.
- Do të mbahen pastër mjediset e jashtme të impiantit, përfshirë shpërndarjen aksidentale të plehut dhe karkasave, të cilat në mjedise të hapura dhe kushte specifike moti janë burim i patogjenëve.

- Duke siguruar higjienë dhe kujdes shëndetësor për shpendët brenda impiantit, bie rreziku i përhapjes së patogjenëve për popullata të shpendëve të egër që mund të frekuentojnë zonën.

5.1.8 Masa të tjera

Masa të tjera të nevojshme për zbutjen dhe minimizimin e ndikimeve në fazën operacionale përfshijnë:

- Rrethimin e impiantit dhe vendosjen e tabelave ndaluese për hyrjen e personave të paautorizuar.
- Kontrollin dhe mbajtjen pastër të rrugëve lidhëse dhe shesheve të instalimit.
- Zbatimin e rregullores së shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve.
- Punësimin (sipas nevojave) e personelit të trajnuar.
- Rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të planit të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin dhe ndryshimet e mundshme.

5.2 Plani i Përfshirjes së Grupeve të Interesuara dhe Trajtimi i ankesave

Për të siguruar marrëdhënie korrekte dhe të pranueshme nga grupet e interesit në zonën e zhvillimit të aktivitetit dhe në të gjithë rajonin, stafi operator do të ndjekë udhëzimet e mëposhtme:

- Do të ndërtojë mënyra komunikimi transparente dhe efçente me të gjitha palët si autoritetet, banorët vendas me qëllim që të merren në kohën e duhur sugjerimet e mendimet e tyre për çështjet e ndryshme që lidhen me veprimtarinë dhe ndikimet e mundshme të tyre. Operatori do të informojë palët e interesuara si autoritetet, banorët vendas në formën dhe mënyrën më të përshtatshme për ta.
- Komunikim i hapur me komunitetin vendas për të sqaruar pritshmërinë e tyre mbi mundësinë apo pamundësinë për punësim afatgjatë.
- Shmangien e konflikteve të mundshme me grupet e interesit dhe zgjidhjen e tyre në mënyrë sa më praktike.
- Operatori do të hartojë dhe zbatojë një Mekanizëm të Trajtimit të Ankesave i cili do të lehtësojë identifikimin dhe zgjidhjen që në fazat më të hershme të problemeve që mund të shfaqen si pasojë e veprimtarisë. Mekanizmi siguron që ankesat nga komunitetet e ndikuara apo dhe nga grupe të interesit të jashtëm/të tjera që gjenden jashtë zonës së impiantit të marrin përgjigje dhe trajtohen në mënyrë serioze.

5.3 Përmbajtja e Planit të Përballimit të Emergjencave

Operatori i impiantit, do të hartojnë një plan të parandalimit dhe përgjigjes ndaj situatave të paprituara emergjente (PPPE), zbatimin e të cilit është i detyrueshëm për të gjithë, përfshirë kontraktorët, gjatë gjithë jetëgjatësisë së instalimit. Këtu përfshihen:

5.3.1 Zjarri

Impianti do të pajiset me sistemin e plotë të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe planin e veprimit përkatës me detyrat dhe përgjegjësitë. Në përbërje të sistemit të mbrojtjes ndaj zjarrit që do të instalohet në objekt është parashikuar fikja me ujë, shkumë apo pluhur në varësi të sektorit ku mund të bjerë zjarr dhe vendosja e mjeteve përkatëse për secilin lloj.

Gjithashtu në vende të dukshme do të vendosen shenja dalluese dhe tabela paralajmëruese si:

- Ndalohet duhani dhe mbajtja e çdo lloj lënde të rrezikshme që mund të provokojë rënien e zjarrit.
- Ndalohet magazinimi dhe përdorimi i mjeteve ngrohëse me flakë si dhe përdorimi nga personeli i këpucëve që shkaktojnë shkëndija nga pjesë metalike.
- Personeli do të trajnohet për veprimet që duhet të kryejë në rast të rënies së zjarrit dhe do të pajiset me uniforma antizjarr.
- Njëkohësisht shoqëria do të kërkojë ndihmën e Njësive të specializuara të mbrojtjes ndaj zjarrit. Një vlerësim i kapaciteteve lokale të fikjes së zjarrit duhet të realizohet bazuar në nevojën për ndërhyrje në skenarin/rastin më të keq të mundshëm.
- Një plan komunikimi me kontaktet përkatëse duhet të hartohet me qëllim që të përdoret për të kordinuar ndërhyrjen e tyre në situatë emergjence.

5.3.2 Epidemitë

- Në impiant duhet të ketë veshje të posaçme për stafin në rast të shfaqjes së epidemive tek shpendët.
- Operatori duhet të ketë parashikuar dhe siguruar mënyrën e asgjësimit të karkasave të shpendëve të ngordhur në mënyrë që të shmanget përhapja e patogjenëve të rrezikshëm.
- Në impiant duhet të jenë present mjetet e nevojshme të ambalazhimit të shpendëve të ngordhur në rast epidemie.
- Një plan komunikimi me autoritet kompetente me qëllim që të përdoret për të kordinuar ndërhyrjen në situatë të tilla emergjente.

Raporti u përgatit nga

“EMA Consulting” sh.p.k - (Liçenca nr. LN-3752-09-2011)

Administratori

Ing.Etleva BODINAKU (MSc.)



